



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 5967/Prot.

Tiranë, më 31.07. 2026

URDHËR

Nr. 400, datë 31.07 2026

PËR

**MIRATIMIN E LLOJEVE TË PROGRAMIT “PAS SHKOLLE”, STANDARDEVE,
KRITEREVE, PLANIT TË VEPRIMIT PËR OFRIMIN E KËTIJ PROGRAMI, SI
DHE PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 4, të nenit 47/1, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të urdhrit nr. 579, datë 11.11.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Herida Duro”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e llojeve të programit “pas shkolle”, standardeve, kriterëve, planit të veprimit për ofrimin e këtij programi, si dhe përcaktimin e institucioneve publike të arsimit parauniversitar për organizimin dhe zbatimin e programit “pas shkolle” në arsimin parauniversitar, përkatësisht sipas shtojcave nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore rajonale dhe vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

HERIDA DURO



Bashkëlidhur kësaj memoje gjeni projekt-urdhrrin “Për miratimin e llojeve të programit ‘Pas shkolle’, standardeve, kriterëve, planit të veprimit për ofrimin e këtij programi, si dhe përcaktimin e institucioneve publike të arsimit parauniversitar”, së bashku me pesë shtojcat përkatëse:

- Shtojca nr. 1 – Llojet e programit “Pas shkolle”;
- Shtojca nr. 2 – Standardet për ofrimin e programit “Pas shkolle”;
- Shtojca nr. 3 – Kriteret për organizimin dhe ofrimin e programit “Pas shkolle”;
- Shtojca nr. 4 – Plani i veprimit për ofrimin e programit “Pas shkolle”;
- Shtojca nr. 5 – Institucionet publike të arsimit parauniversitar në të cilat do të zhvillohet programi;
- Minutat e takimeve të grupit të punës për mbledhjet e zhvilluara.

Për sa më sipër, lutemi për miratimin Tuaj.

Duke Ju falënderuar,